

VENDIM
Nr. 175, datë 26.2.2020

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, PËR AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR, TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL DHE OBJEKTI, NGA PRONA NR. 190, ME EMËRTIM “REGJIMENTI I HELIKOPTERËVE” DHE TË DISA SIPËRFAQEVE TRUALL FUNKSIONAL, NGA PRONAT NR. 1136, ME EMËRTIM “RADIODRITA”, DHE NR. 1137, ME EMËRTIM “HELIODROMI I REPARTIT USHTARAK NR. 3340”, ME VENDNDODHJE NË FARKË, TIRANË, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të një sipërfaqeje truall funksional dhe objekti, me sipërfaqe të përgjithshme prej 792.9 (shtatëqind e nëntëdhjetë e dy pikë nëntë) m², nga prona nr. 190, me emërtim “Regjimenti i helikopterëve”, të një sipërfaqeje truall funksional prej 863.23 (tetëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë njëzet e tre) m², nga prona nr. 1136, me emërtim “Radiodrita”, dhe të një sipërfaqeje truall funksional prej 2 341 (dy mijë e treqind e dyzet e një) m², nga prona nr. 1137, me emërtim “Heliodromi i repartit ushtarak nr. 3340”, me vendndodhje në Farkë, Tiranë, sipas planvendosjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për t’i përdorur për ndërtimin e rrugës publike, në segmentin rrugor “Unaza lindore Tiranë loti 2”.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet sipërfaqja truall funksional dhe objekt, me sipërfaqe të përgjithshme prej 792.9 (shtatëqind e nëntëdhjetë e dy pikë nëntë) m², nga prona nr. 190, me emërtim “Regjimenti i helikopterëve”, sipërfaqja truall funksional prej 863.23 (tetëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë njëzet e tre) m², nga prona nr. 1136, me emërtim “Radiodrita”, dhe sipërfaqja truall funksional prej 2 341 (dy mijë e treqind e dyzet e një) m², nga prona nr. 1137, me emërtim “Heliodromi i repartit ushtarak nr. 3340”, me vendndodhje në Farkë, Tiranë, sipas planvendosjeve, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të sipërfaqeve të pronave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t’i tjetërsojnë ose t’ua japin ato në përdorim të tretëve.


4. Për sigurinë dhe ruajtjen e pronave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar, para fillimit të punimeve, të ndërtojë rrethimet në kufijtë e rinj të pronave, duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e ndërtimit të segmentit rrugor, sipas parametrave dhe kushteve teknike dhe për

këtë të hartohet aktmarrëveshje ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të përfaqësuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, të përfaqësuar nga Komanda e Forcës Ajrore.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



MIRATOHET
ZV/KOMANDANTI FORCËS AJRORE
Kolonel Edisson ZARKA

Plan Vendosije e Pronës nr.1136, "Radio Drita", Surrel, Farkë, Tiranë
(Sipërfaqja që i mbetet pronës)

SISTEMI SHITËTËROR I KOORDINATAVE



Shpjeguese:

— Kufiri i pronës

Sipërfaqja që i mbetet pronës = 4424 m²

Gjatësia e rrethimit që prishet = 100,5 m

Gjatësia e rrethimit që do të ndërtohet = 101 m


Shënim :

Kjo plan vendosje u hartua në zbatim të shkresës së SHSHPPA nr.10258/1, datë 19.12.2019, bazuar në dokumentacionin teknik të kësaj prone të marrë në arkivin e IGJIU, hedhur mbi projektin e zbatimit të segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, Lati 2, të vë në dispozicion me shkresën e mësipërme, si dhe nga ARRSH në formatin elektronik.

Punoi :
Topograf Nikollë TUSHI

SHKALLA 1:2500


ZV/DREJTORI I IGJIU
Ark.Enea SINOIMERI



Ripunuar Dhjetor 2019

Plan Vendosija e Pronës nr.1137, "Heliodromi", Farkë, Tiranë
"Sipërfaqja që i mbetet pronës"

SISTEMI SHITETËROR I KOORDINATAVE



Janar 2019
4575
700
406 050

Shkalla 1:2500

Punoi
Topograf Nikoll TUSHI

Ripunuar Dhjetor 2019

ZV/DREJTORI I IGJIU
Ark.Enea SINOIMERI



Plan Vendosja e Pronës nr.190, "Baza Ajrore, Ish Regjimenti nr.4040", Farkë, Tiranë
"Sipërfaqja që prek projekti rrugës"


SISTEMI SHITETOR I KOORDINATAVE

MIRATOHET
ZV/KOMANDANT I FORCËS AJRORE
Kolonel Editsen **ZARKA**



Shpjeguese:

— Kufiri i pronës
Sipërfaqja e përgjithshme e pronës = 394057.9 m²
Sipërfaqja që zë projekti i rrugës 792.9 m²
në këtë sipërfaqe shtrihet dhe një objekt me sip.15.08 m²
Sipërfaqja e pronës që mbetet = 393265 m²
Gjatësia e rrethimit që prishet = 191.6 m
Gjatësia e rrethimit që do të ndërtohet = 191.6 m



Shënim:

Kjo plan vendosje u hartua në zbatim të shkresës së SHSHPPA nr.10258/1, datë 19.12.2019, bazuar në dokumentacionin teknik të kësaj prone të marrë në arkivin e IGJIU, hedhur mbi projektin e zbatimit të segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, Loti 2", të vëna në dispozicion me shkresën e mësipërme, si dhe nga ARRSH në formatin elektronik


Ripunuar Dhjetor 2019

Punoi
Topograf Nikoll TUSHI

(Signature)

SHKALLA 1:5000


ZV/DREJTORI I IGJIU
Ark. Enca **SINOIMERI**



MIRATOHEJ
ZV/KOMANDANTI FORCËS AJRORE
Kolonel Edisson ZARKA

Plan Vendosja e Pronës nr.1136, "Radio Drita", Surrel, Farkë, Tiranë
(Sipërfaqja që prek projekti i rrugës)

SISTEMI SHITËRËOR I KOORDINATAVE



Shpjeguese:

- Pjesa që zëprojekti i rrugës = 863.23 m²
- Gjatësia e rrethimit që prishet = 100,5 m
- Gjatësia e rrethimit që do të ndërtohet = 101 m

Shënim :

Kjo plan vendosje u hartua në zbatim të shkresës së SHSHPPA nr.10258/1, datë 19.12.2019, bazuar në dokumentacionin teknik të kësaj prone të marrë në arkivin e IGJIU, hedhur mbi projektin e zbatimit të segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, Lati 2, të vënë në dispozicion me shkresën e mësipërme, si dhe nga ARRSH në formatin elektronik.

ZV/DREJTORI I IGJIU
Ark.Enea SINOIMERI


SHKALLA 1:2500

Punoi :
Topograf Nikoll TUSHI

Ripunuar Dhjetor 2019

Plan Vendosja e Pronës nr.1137, "Heliidromi", Farkë, Tiranë
"Sipërfaqja që prek projekti rrugës"


SISTEMI SHITETËROR I KOORDINATAVE



Punoi
Topograf Nikoll TUSHI


Ripunuar Dhjetor 2019

ZV/DREJTORI I IGJIU
Ark.Enea SINOIMERI



Plan Vendosja e Pronës nr.190, "Baza Ajrore, Ish Regjimenti nr.4040", Farkë, Tiranë
"Sipërfaqja që prek projekti rrugës"

SISTEMI SHITETËROR I KOORDINATAVE



Punoi
Topograf Nikoll TUSHI

SHKALLA 1:5000

ZV/DREJTORI I IGJIU
Ark. Enea SINOIMERI



Plan Vendosija e Pronës nr.1137, "Heliodromi", Farkë, Tiranë
"Sipërfaqja që prek projekti rrugës"

SISTEMI SHITETËROR I KOORDINATAVE

576
200

MIRATOHET
ZV/KOMANDANTI I FORCËS AJRORE
Kolonel **Edison ZARKA**




575
950

4 575
700
4 406 050

Punoi
Topograf **Nikoll TUSHI**

Ripunuar Dhjetor 2019



Shpjeguese:
Kufiri i pronës që zë projekti i rrugës
Sipërfaqja që zë projekti i rrugës = 2341 m².
Gjatësia e rrethimit që prishet = 182.6 m
Gjatësia e gardhit që do të ndërtohet = 151.5 m

Shënim:
Kjo plan vendosje u hartua në zbatim të shkresës së SHSHPPA,
nr.10258/1, datë 19.12.2019, bazuar në dokumentacionin teknik
të kësaj prone të marrë në arkivin e IGJIU, hedhur mbi projektin
e zbatimit të segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, Loti 2", të
vënë dispozicion me shkresën e mësipërme, si dhe nga ARRSH
në formatin elektronik

Shkalla 1:2500


ZV/DREJTORI I IGJIU
Ark.Enea **SINOIMERI**



MIRATOHET
ZV/KOMANDANTI FORCËS AJRORE
Kolonel Edlison ZARKA

Plan Vendosja e Pronës nr.1136, "Radio Drita", Surrrel, Farkë, Tiranë
(Sipërfaqja që prek projekti i rrugës)

SISTEMI SHITËTOR I KOORDINATAVE



Shpjeguese:

■ Pjesa që zëprojekti i rrugës = 863.23 m²
■ Gjatësia e rrethimit që prishet = 100.5 m
■ Gjatësia e rrethimit që do të ndërtohet = 101 m

Shënim :

Kjo plan vendosje u hartua në zbatim të shkresës së SHSHPPFA nr.10258/1, datë 19.12.2019, bazuar në dokumentacionin teknik të kësaj prone të marrë në arkivin e IGJUI, hedhur mbi projektin e zbatimit të segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, Lati 2, të vënë në dispozicion me shkresën e mësipërme, si dhe nga ARRSH në formatin elektronik.

SHKALLA 1:2500

ZV/DREJTORI I IGJUI
Ark. Enea SINOIMERI

Punoi :

Topograf Nikoll TUSHI

Ripunuar Dhjetor 2019